



## **Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Nr. 05**

Datë: 10. 03. 2017. Ora: 10:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Bajram Ljatifi, anëtar i KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Binak Vishaj, Bajram Ljatifi, Ercan Spat dhe Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ.

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).  
Përkthyes: Vera Dula

### **Rendi i ditës**

#### **1. Hyrje: z. Bajram Ljatifi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

#### **2. Aktivitetet e ZRPP-së**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për shfuqizimin e pezullimit për tri (3) parti politike;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për shqiptimin e gjobës për tri (3) parti politike;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimi për çregjistrimin e një (1) partie politike;*

#### **3. Raport i Këshillave të KQZ-së;**

##### **• Këshilli për Çështje Ligjore;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Vushtrri dhe Mitrovicë;*
- *Shqyrtimi dhe miratim i Draft Udhëzimit Administrativ për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Memorandum Bashkëpunimit në mes të KQZ-së dhe Ministrisë së Diasporës;*

##### **• Këshilli për Buxhet dhe Financa;**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Aftatmesme të Shpenzimeve 2018-2020;*

#### **4. Të ndryshme**

## **1. Hyrje: z. Bajram Ljatifi, kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.03/2017*

**Bajram Ljatifi**: Janë plotësuar kushtet që, ne të fillojmë me këtë mbledhje të cilën, në bazë të autorizimit të kryetares dhe të rregullores së punës së KQZ-së, do ta udhëheqë unë. Konstatohet se, në mbledhje marrin pjesë 9 anëtar të KQZ-së, kurse mungojnë 2. Para jush, është rendi i ditës të cilin dhe pyes nëse, dikush ka ndonjë propozim, ndonjë plotësi lidhur me miratimin e rendit...? Po, është lajmëruar drejtoresha e Administratës. Miradije Meha: Të nderuar anëtar, krye shefi është mungon tash e dy janë, dhe më ka autorizuar mua për t'i ushtruar detyra, mirëpo kërkoj nga një autorizim lidhur me këtë në mënyrë që unë, të mund t'i kryejë detyrat e krye shefit në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi të KQZ-së. Prandaj, propozoj që ta shqyrtoni autorizimin e krye shefit të Sekretariati...

**Bajram Ljatifi**: Vazhdojmë me pikën e parë.

## **2. Aktivitetet e ZRPP-së**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për shfuqizimin e pezullimit për tri (3) parti politike*

**Miradije Mavriqi**, drejtoreshë e ZRPP-së, tha se, zyra ka përgatitur rekomandimet për shfuqizimin e pezullimit për tri (3) parti politike, dhe se deri më datën 27 shkurt 2017, ka qenë afati i fundit i KQZ-së i dorëzimit të të dhënave të partive politike. Andaj, të dhënat e ndryshuara, i kanë dorëzuar 3 parti. Dhe ne kërkojmë nga KQZ, ta shfuqizoj pezullimin për këto parti.

**Bajram Ljatifi**: A dëshiron dikush ta marrë fjalën...? Jo, atëherë, ju ftoj ta miratojmë këtë rekomandim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rekomandimin e zyrës shfuqizimin e pezullimit për këto parti:

*1. Partia Liberale e Kosovës*

*2. Partia Nacionaldemokratike Shqiptare*

*3. Fronti Nacional i Bashkimit Demokratik*

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimit për shqiptimin e gjobes për tri (3) parti politike*

**Miradije Mavriqi**: Këto parti politike, e kanë dorëzuar dokumentacionin e kërkuar mirëpo, iu shqiptohet gjoba sipas nenit 20 të rregullës 14/2015. Gjjobat, kategorizohen mbi kriteret e caktuara, dhe këto parti që gjjobiten nuk janë pjesë e parlamentit. Gjjoba, ju shqiptohen

varësisht nga ajo se, sa ditë janë vonuar. Listën e partive e keni, ashtu si edhe draft vendimet.

**Bajram Ljatifi:** A dëshiron dikush ta marrë fjalën...? Jo, atëherë, ju ftoj ta miratojmë këtë rekomandim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rekomandimin e zyrës për shqiptimin e gjobave në vlerë prej 350 euro 3 partive politike.

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Rekomandimi për ç 'regjistrimin e një (1) partie politike*

**Miradije Mavriqi:** Zyra, po ashtu ka përgatitur rekomandimin për ç 'regjistrimin e një (1) partie politike, nga 8 sa ishin të pezulluara nga KQZ-së. Një parti, edhe pse është lajmëruar, nuk ka dorëzuar fare azhurnime. Bëhet fjalë për Lëvizjen e Re Demokratiane. Zyra, sipas nenit 8, rekomandon KQZ-në për ç 'regjistrim.

**Adnan Rrustemi:** E kam një pyetje: kjo parti, e ka kaluar periudhën prej 20 ditësh, dhe nuk është përgjigjur...?

**Miradije Mavriqi:** Po, nuk është përgjigjur...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimisht rekomandimin e zyrës për ç 'regjistrimin Lëvizjen e Re Demokratiane nga Regjistri i Partive Politike.

### **3.Raport i Këshillave të KQZ-së;**

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal në Vushtri dhe Mitrovicë

**Sami Hamiti:** Ne, në mbledhjen e fundit të Këshilli për Çështje Ligjore, i kemi shqyrtuar 2 kërkesa nga komunat, dhe kemi konstatuar se të dy këto kërkesa i plotësojnë kushtet ligjore, dhe i sugjerojmë KQZ- së që t'i miratojë këto zëvendësime të kuvendeve komunale në Vushtri dhe në Mitrovicë.

**Bajram Ljatifi:** A dëshiron dikush ta marrë fjalën...? Jo, atëherë, ju ftoj ta miratojmë këtë rekomandim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan unanimitisht rekomandimet e Këshillit për Çështje Ligjore zëvendësimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe të Mitrovicës.

*Shqyrtimi dhe miratim i Draft Udhëzimit Administrativ për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale*

**Sami Hamiti**: Në mbledhje, e kemi shqyrtuar edhe këtë pikë. Pra, e kemi analizuar draftvendimin, edhe pse ka qenë edhe më herët, madje edhe në KQZ, por që është kthyer mbrapa. Me sugjerimet e bëra edhe nga administrata, dhe gjatë shqyrtimit në këshill sërish, rekomandojmë KQZ-në që miratoj këtë Draft udhëzim Administrativ për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale.

**Bajram Ljatifi**: A dëshiron dikush ta marrë fjalën...? Urdhëroni...

**Adnan Rrustemi**: Është mirë që ky draft ka disa përmirësime, i precizon disa udhëzime, për mendimin tim nuk është që i plotëson të gjitha...Ka pasur më shumë hapësirë, sepse mendoj që kemi mundur ta zgjerojmë domenin e fushëveprimit tonë, sidomos kur asamblistët mungojnë për një kohë të gjatë, dhe ndërkohë, nuk iniciohet procedura. Nuk po propozoj që kjo të përfshihet, por e di që për shembull një rast në Istog, asamblisti ka munguar më shumë se një vit, dhe në këso raste, vendi i asamblistit nuk mund të mbahet peng... Z. Rrustemi, në vazhdim të diskutimit të tij, elaboroi problemet që dalin në rastet kur asamblistët i bishtërojnë zëvendësimit, dhe e mbajnë peng vendin e asamblistit me qëllim që të mos mund të ngritët procedura për zëvendësimin e tyre...

**Eshref Vishi**: Është mirë që ndodhin rishikime të akteve normative, në këtë të udhëzimeve administrative, mirëpo praktika me të cilën trajtohen aktet, mua nuk po më pëlqen, dhe nuk po më duket në rregull. Propozohet ndryshim plotësim i një akti, kurse në tavolinë neve na vie një akt i për miratim. Ne, i dimë procedurat dhe dallimet në këtë aspekt...Dua të them se, udhëzimet administrative plotësohen në kuptim të mangësive që janë evidentuar gjatë zbatimit të aktit, por jo edhe në këtë rast...

**Binak Vishaj**: Është mirë që ky draft vjen nga Këshilli për Çështje Ligjore, e i cili edhe i trajton të gjitha kërkesat për zëvendësim të asamblistëve, dhe këta, sfidohen në situatat më të vështira...Sepse, kemi pas situata në mungesë të procedurës ligjore, dhe duke i pasur parasysh situatat, unë po besoj që i kanë plotësuar në përqindjen e duhur boshllëqet...Kurse, kur asamblisti që e ndërron vendbanimin, atë që e pasqyroj Adnani, është bukur vështirë që të fillohet procedura e zëvendësimit...

Në këtë drejtim, tha z. Vishaj, duhet t'i japim një rol të caktuar kryesuesit të Asamblesë Komunale...

**Sami Hamiti**: Në këshillë, e kemi shqyrtuar pikërisht këtë çështje kur asamblisti pozicionohet, pra, si kemi me e ndërruar...Atë ditë në mbledhje, u pa se kjo është një çështje e komplikuar. Se, është problem me e ditë edhe kryesuesi se, a e ka ndryshuar vendbanimin sepse, ai vjen normalisht, dhe merr pjesë...Nuk ka si me ditë...

**Adnan Rrustemi:** Si e shoh, unë mendoj se duhet të rritet edhe roli i KQZ-së për me u dhanë palëve mundësinë se si me i paraqitë dokumentet. Unë, e shoh që preken të drejtat e asambleistit të radhës, dhe mendoj që edhe ky, mund ta ngris çështjen...Pra, këtu shkelne edhe të drejtat...! Mendoj që, duhet të lihet hapësira...

**Sami Hamiti:** Kushdo që e qon kërkesën, kryesuesi e ka obligim ligjorë me e iniciuar zëvendësimin...

**Ilir Gashi:** Te humbja e mandateve, a është e përcaktuar me ligj...? Nëse është, pra, në momentin e betimit të asamblistëve, duhet njoftuar ata që nëse e ndërron vendbanimin dhe nuk e lajmëron, kjo është vepër penale...Ata, duhet ta din këtë...

**Bajram Latifi:** Mendo që, kur ka kësi rasti, kur i pushon mandati, ndërrim i vendbanimit etj., kryesuesi është mirë që së paku në gjashtë muaj, t'i verifikoj këto...Ne, mundemi me aktet tona, që të kërkojmë nga kryesuesi të na njoftoj se kush ka bërë ndërrim të vendbanimit...

**Binak Vishaj:** Propozoj që, ne ta kemi mundësinë që, kryesuesi i asamblesë, kandidati në vazhdim dhe kush do tjetër që ta njoftojë KQZ-në që, një nga asamblistët e ka ndërruar vendbanimin. Ne, duhet ta fusim këtë në draft...

**Adnan Rrustemi:** Po, mendoj që për dy kategori duhet dhënë mundësia palëve tjera që me e ngritë çështjen, por jo me iniciuar procedurën sepse, vetëm kryesuesi e inicion çështjen...Por, duhet me pas njëfarë konsensusi...

Në këtë pikë, në vazhdim diskutuan: Bajram Lajatifi, Ilir Gashi, Binak Vishaj, Sami Hamiti, Emira Alishi (zyrtare ligjore).

**Bajram Ljatifi:** Konstatoj se, i kemi shterë diskutimet në këtë pikë. Kush është për propozimin që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi...Kush është për...?

**Anëtarët e KQZ-së,** miratuan shqyrtimet dhe plotësimet e udhëzimit administrativ në mënyrë unanime në lidhje me zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve komunale.

*Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Memorandum Bashkëpunimit në mes të KQZ-së dhe Ministrisë së Diasporës*

**Sami Hamiti:** Edhe këtë draft – memorandum e kemi diskutuar në mbledhjen e fundit për çështje ligjore. Kemi një dakordancë me ministrinë, ngase më herët janë shqyrtuar çështjet dypalëshe. Ne, së fundi, në mbledhje kemi bërë dy – tri intervenime të vogla, prandaj këshilli sugjeron për aprovim të draftit, dhe që pastaj të nënshkruhet.

**Adnan Rrustemi:** E vlerësoj dhe e përkrahu memorandumun dhe shpresoj që ky t'i kontribuoj diasporës, të drejtave të tyre për votim, lehtësimit të procedurave etj. Si institucion, mendoj që ne duhet të kemi një plan në mënyrë që, diaspora të merr pjesë në zgjedhje sipas procedurave të lehtësuara... Mendoj që, me rëndësi është të kemi një memorandum, sidomos me Ministrinë e Punëve të Jashtme, në mënyrë që të përkufizohet roli i ambasadave dhe konsullatave në mënyrë që ato,

të jenë aktive në këtë drejtim...Po e theksoj si kërkesë që, shpjegimet të vendoset një kontakt me këtë ministri...

**Sami Hamiti**: Pajtohem me atë që u tha: më i rëndësishëm është bashkëpunimi me ministrinë e jashtme, e për t'u ikur fushave politike, meqë organizatat, shoqatat, edhe mund të jenë të lidhura me partitë politike...Një memorandum i këtillë, do ishte i rëndësishëm...

**Binak Vishaj**: Edhe ky memorandum, edhe memorandumet e tjera, edhe gjithçka që është në lehtësim të pjesëmarrjes së votuesve në zgjedhje, pra e pjesëmarrjes së diasporës në zgjedhje është me rëndësi...Kurse, me atë që u tha, pavarësisht shpjegimit të adresave, nëse nuk është materiali, atëherë nuk është produktive...U tha, por jam edhe unë që roli i Ministrisë së Jashtme është i pazëvendësueshëm...Pra, ne po i anashkalojmë institucionet, ambasadat, konsulatat dhe, duhet të takohemi me përfaqësuesit e institucioneve...

Numri i pjesëmarrësve nga diaspora që votojnë, është shumë i vogël, tha z. Vishi...

**Ilir Gashi**: Pajtohem që, ndoshta memorandum i parë ishte dashur të bëhet me ministrinë e jashtme për shumë arsye, mirëpo, e mbështes edhe këtë memorandum. Por, duhet pak të plotësohet me informacione...

Në këtë pikë, diskutuan më tutje: Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi.

Anëtarët e KQZ-së, me 8 vota, miratuan këtë memorandum.

#### **4.Këshilli për Buxhet dhe Financa;**

##### *Shqyrtimi dhe miratimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2018-2020*

**Ilir Gashi**: E kemi trajtuar këtë kornizë që është obligim ligjor, dhe mendoj që drejtoresha, mund të shpjegoj më shumë detaje.

**Sami Hamiti**: Kam vërejtje, sepse mendoj që ky dokument nuk thotë asgjë, sepse këtu nuk barazohen shifrat. Shumat e përcaktuara, nuk barazohen me planifikim. Pse nuk janë shifrat e duhura...Si i keni elaboruar shpenzimet, barazimet...? Ky dokument, unë mendoj që duhet të rishkruhet...dokumenti ka diferenca të mëdha, sepse shifrat janë kokëforta dhe nuk na lënë me gabuar...!

Unë, këtë dokument nuk e votoj...

**Miradije Meha**: Ky dokument, është hartuar mbi kornizat e ardhura nga ministria e financave...Dhe ne, duhet t'i dërgojmë në ministri, vetëm shumat totale...

**Sami Hamiti**: Ka mos përputhje, kush janë njësitë që kanë bërë kërkesa...?

Drejtoresha, znj. Miradije Mavriqi, dhe shpjegime se, ku dhe nga cilat njësi, burojnë shumat në kornizë...Megjithatë, z. Hamiti, nuk u pajtua me një pjesë të shpjegimeve të dhëna...

Bajram Ljatifi: Mendoj që diskutime s'ka më: Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kornizën afatmesme të shpenzimeve 2018-2020 me 7 vota për, dhe 1 abstenim.

## **5. Të ndryshme**

Në vazhdim të mbledhjes, anëtarët e KQZ-së diskutuan lidhur me kërkesën e znj. Miradije Meha për bartjen e përgjegjësi të krye shefit, mbi bazën e ushtrimit të kësaj detyre me autorizime të plota në mungesë të krye shefit.

Anëtarët e KQZ-së (Sami Hamiti, Binak Vishaj, Bajram Ljatifi, Eshref Vishi, Adnan Rrustemi, Ilir Gashi) pasi shqyrtuan këtë kërkesë vlerësuan se, znj. Miradije Meha si ushtruese e detyrës së krye shefit, ka të gjitha kompetencat për ta ushtruar detyrën në plotëni...

**Për KQZ**

**Bajram Ljatifi, anëtar**

-----